



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 401-552 /2018

Klinë, dt.02.02.2018

Duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 91 të Statutit të Komunës së Klinës, të dt.07.04.2010, në nenin 2 pika 2.3 dhe nenin 4 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr. 03/L-49, si dhe duke marrë parasysh Mendimi Profesional të DKRS nr.10-451-548/18 të dt.02.02.2018 për subvencionimin e klubit të futbollit "Dukagjini" si dhe kërkesën e KF "Dukagjini" nr.01-553-472/2018, Kryetari i Komunës së Klinës, më dt. 02.02.2018, **mori;**

V E N D I M

I. LEJOHËT, ndarja e mjeteve financiare në shumën prej 1,500.00 € (njëmijë e pesëqind euro) për KF "Dukagjini" në Klinë, me qëllim të mbulimit të shpenzimeve për fillimin e aktiviteteve pranverore sportive.

Arsyeja e ndarjes së mjeteve bëhet me kërkesën e KF "Dukagjini" për aktivitetet sportive për fillim sezoni, ne përputhje edhe me mendimin profesional të Drejtorisë së Kulturës për mbështetjen financiare.

Mjetet në vlerë prej 1,500.00 € paguhen nga subvencionet e Drejtorisë së Kulturës, Rinise dhe Sportit.

II. Mjetet si nga pika 1 e këtij vendimi do të paguhën në xhirollogarinë e KF "Dukagjini" nr. 17-09-2000090028.59 në NLB Prishtina.

III. Për ekzekutimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës, Rinise dhe Sportit.

IV. Obligohet, KF "Dukagjini" që për të gjitha mjetet e ndara në shumën e lartcekur Komunës së Klinës t'ia paraqes raportin kthyes zyrtar të shpenzimeve.

V. Pjese përbërëse e këtij vendimi është, kërkesa e KF "Dukagjini" nr.01-553-472/18 e dt.30.01.2018, Mendimi profesional e DKRS nr.10-451-548/18 i dt.02.02.2018 si dhe dokumentacioni tjetër në lende.

VI. Ky vendim është i plotëfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

VII. Me vendim të njoftohet: Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, DKRS, KF "Dukagjini", si dhe Arkivi.





Komuna e Klinës
Kryetari i Komunës
01Nr. 644-630 /2018
Klinë dt. 07.02.2018

Duke u bazuar ne nenin 13 të LVQL, Ligji 03/L-040, botuar ne gazeten zyrtare nr.28/2008, nenin 91 të Statutit të komunës së Klinës të dt. 07.04.2010 si dhe duke marrë parasysh shënimin e 10 vjetorit te Pavarësisë së Kosovës, me dt. 07.02.2018, Kryetari i Komunës së Klinës, **merr:**

V E N D I M

*Për formimin e këshillit organizativ për shënimin e 10 vjetorit te shpalljes së Pavarësisë së Kosovës,
17 shkurt 2008- 17 shkurt 2018*

I. FORMOHËT, këshilli organizativ për shënimin e 10 vjetorit te shpalljes e Pavarësisë se Kosovës, ne këtë përbërje:

1. Kryetari i Komunës, z. Zenun Elezaj kryesues;
2. Nënkryetari i Komunës, z. Besim Hoti;
3. Drejtori i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, z. Skënder Merturi;
4. Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, z. Arben Limanaj;
5. Nga një përfaqësues i shoqatave te dala nga lufta e UÇK-së;
6. Nga një përfaqësues i subjekteve politike qe përfaqësohen ne Kuvendin e Komunës;

II. Këshilli organizativ si nga pika 1 e këtij vendimi do të bëjë të gjitha pergatitjet rreth organizimit dhe manifestimeve të cilat do të mbahën për shënimin e 10 vjetorit të Pavarësisë se Republikës së Kosovës.

III. Ky vendim është i plotëfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë, i cili zbatohet nga ana e këshillit organizativ.

Te njoftohen:

- Anëtarët e këshillit organizativ;
- Një kopje ekzekutivi;
- Një kopje per tabelën e shpalljeve,si dhe;
- Arkivi i Komunës.



Kryetari,
Zenun Elezaj



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 359-840 /2018

Klinë, dt. 16.02.2018

Duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, publikuar në gazetën zyrtare, me dt. 04.06.2008 nr.28, në nenit 91 paragrafi 1 i Statutit të Komunës së Klinës të dt.07.04.2010, si dhe duke marrë parasysh dispozitat e U.A nr.07/2016 të MTI për Procedurat e Shitjes së Mallrave me Ankand Publik me kërkesën e DKA per shitje te mallrave, Kryetari i Komunës së Klinës, më dt. 16.02.2018, mori;

V E N D I M

Për caktimin e anëtares se trete te komisionit për zhvillimin e procedurave për shitjen mallrave me ankand publik- dyer dhe dritare te vjetra te objektit te shkollës "Luigj Gurakuqi" Klinë

I. EMËROHET, SUZANA GJERGJI anëtare e trete add hoc ne komisionin per zhvillimin e procedurave per shitjen e mallrave me ankand publik- dyerve dhe dritareve te vjetra te objektit te shkollës "Luigj Gurakuqi" ne Klinë.

II. Detyrat e komisionit për zhvillimin e procedurave janë: përgatitja e ftesës për ankand publik, përgatitja e listës se mallrave te cilat do te shiten me ankand dhe çmimin fillestar te tyre, te përgatitur nga njësia e logjistikes, përcakton datën, afatin kohor dhe vendin e prezantimit te mallrave para shpalljes se ankandit, pranon ofertat nga ofertuesit si dhe veprimet tjera te përcaktuara me U.A.

III. Mandati i anëtares se trete te komisionit për zhvillimin e procedurave është vetëm per ketë rast, e cila punën e vete e kryen ne përputhje me autorizimet e dhëna me ketë vendim si dhe Udhëzimin Administrativ te MTI nr.07/2016 për Procedurat e Shitjes se Mallrave me Ankand Publik.

IV. Ky vendim është i plotëfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

V. Me vendim të njoftohet: zyra e kryetarit, anëtarja e komisionit, dy anëtares e tjerë te komisionit per zhvillimin e procedurave si dhe Arkivi.

